



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në zbatim të neit 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr.04/L-106 për Teatrot, të pikës 3 të Rekomandimit të KK-Gjiçan 01.Nr.016-49454 të dates 26.05.2015, të nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve 01.Nr.016-144327 të datës 30.12.2014, e në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur me 28.07.2016, merr:

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim e aktiviteteve të Teatrit të Qytetit të Gjiçanit për vitin 2016

1. Me këtë vendim, Teatrit të Qytetit të Gjiçanit i ndahet subvencioni në mjete financiare në lartësi prej 70,000.00 €.
2. Shuma e mjeteve si në pikën 1. të këtij vendimi, Teatrit të Qytetit të Gjiçanit i ndahen për subvencionimin e aktiviteteve të tij në mënyrë që Teatri të përformoj konform projekteve të parapara dhe në kushte normale deri në fund të vitit 2016, bazuar në projektin për funksionimin e Teatrit të Qytetit Gjiçan i cili është pjesë e këtij vendimi.
3. Mjetet financiare ndahen nga Kodi Buxhetor i Njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport-kategoria e shpenzimeve të Subvencioneve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset ekzekutivi i Komunës, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesja e KK-Gjiçan.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01.Nr. 016-74738
Gjiçan, më 28.07.2016

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi